



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK



Nr. 465/3 prot.

Pukë, më 25.03.2026

VENDIM

Nr. 14 datë 25.03.2026

“PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I BASHKISË PUKË
Z. KADRI MORINA

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa “m”; ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, Keshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e tij me date 25.03.2026, pas shqyrtimit;

VENDOSI:

1. T’i akordojë titullin “QYTETAR NDERI” i Bashkisë Pukë.

Z. KADRI MORINA

Me motivacionin:

“Në shenjë vlerësimi dhe mirënjohjeje për kontributin e çmuar në mbështetje të zhvillimit dhe mirëqenies së komunitetit. Përmes financimeve dhe donacioneve të vazhdueshme ka realizuar objektiva dhe iniciativave me interes kulturor dhe publik, lidhur me promovimin dhe kultivimin e vlerave përmes solidaritetit dhe humanizmit, veçanërisht në ndihmë të shtresave në nevojë; si dhe për lidhjen e veçantë dhe miqësinë e dëshmuar ndër vite me qytetin dhe komunitetin e Pukës.”

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Pukë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Vendimi u shpall me date **25. 03 .2026**
Vota të vlefshme gjithsej 11
Vota pro 11 , Vota kundër 0 , Vota abstenim 0

SEKRETARI

Hazbi Terbuni

KRYETARI

Gjon GJOKA

